



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

u.d. Rektor

Prof. Dr. Anton Berishaj

Nr. Prot.: 959

Datë: 29/5/2014

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.5.2014, mori këtë

V E N D I M


- I. Miratohet Rregullorja e Procedurave Vlerësuese për Zgjedhjen dhe Avancimin e Personelit Akademik në Universitetin e Prishtinës.
- II. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga rektori dhe do të vlejë edhe për rastet të cilat janë në procedurë të papërfunduar.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh domosdoshmërinë për hartimin e një rregulloreje për procedurat e vlerësimit, të zgjedhjes dhe të avancimit të personelit akademik në Universitetin e Prishtinës, sipas së cilës do të sqarohen në mënyrë më të hollësishme kriteret për vlerësimin e kandidatëve, gjithnjë brenda kornizave të akteve ligjore dhe nënligjore, Senati i Universitetit të Prishtinës, me shumicë absolute të votave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Menaxhmentit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike të UP-së;
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
4. Zyrtarit ligjor të UP-së;
5. Arkivit të UP-së.



Prof. dr. Anton Berishaj

U. d. i rektorit të UP-së